



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 801, Datë 21.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë AGRO BLEND SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 ‘Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”, për sa i takon shoqërisë “Agro Blend” SHPK

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 44, neni 74, pika 1 germa b, neni 75 pika 1 dhe neni 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “Agro Blend” SHPK për shfuqizimin e Vendimit nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore”,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 783, datë 12.03.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore.

Për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore nga mundësia e shkeljeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, lidhur me sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg morri Vendimin nr. 784, datë 12.03.2021 për vendosjen e masës së përkohshme.

Në vijim të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës u kryen inspektime dhe analiza të ndërmarrjeve që janë nën hetim, nga ku rezultoi se ndërmarrja ankuese “Agro Blend” SHPK ka sjellje të koordinuar në kuptimtë nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003, për produktet plehra kimike: Hidrogjenortofosfat diamoni (DAP), Nitrat dhe URE. Ndërmarrja ankuese ka rritur çmimin e produkteve në tregun e plehrave kimike nga muaji shkurt 2021 e në vijim edhe pse ka marrë dijani për marrjen e masës së përkohshme nga Komisioni i Konkurrencës. Lidhur me Vendimin nr. 794, datë 27.04.2021 të Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrja “Agro Blend” SHPK ka paraqitur ankim me shkresën nr. 138/59 prot., datë 11.05.2021. Nëpërmjet këtij ankimi ndërmarrja “Agro Blend” SHPK ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me VKK nr. 794, datë 27.04.2021 dhe në përfundim ka kërkuar shfuqizimin e tij.

Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit, ndërmarrja “Agro Blend” SHPK nuk ka paraqitur shkaqe ligjore që të mbështesin një kërkesë të tillë në Autoritetin e Konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 74, pika 1/b, kur konstaton se nuk janë zbatuar kushtet dhe detyrimet e dhëna ndaj ndërmarrjeve në vendimin e masës së përkohshme, merr vendim për sanksionimin e tyre me gjobë.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “Agro Blend” SHPK është i pabazuar në ligj pasi sjellja e ndërmarrjes është në shkelje të nenit 44 të ligjit nr. 9121/2003, për masat e përkohshme. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën për të marrë vendime, konkretisht dhënien e masave të përkohshme për raste urgjente, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Lidhur me pretendimet e “Agro Blend” SHPK, për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d), nenit 26, nenit 44, nenit 74, pika 1 germa b, nenit 75 pika 1 dhe nenit 76 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Agro Blend” SHPK për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 794, datë 27.04.2021 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatim të masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021 ‘Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore’”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS